



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

10.06.2023

*“Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave  
në Republikën e Shqipërisë”*

#### ALTERNATIVA (17 x 1 pikë)

##### 1. Tatimpaguesi mund të dërgojë një deklaratë tatimore të ndryshuar:

- a) brenda 5 vjetësh nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare për tatimin mbi fitimin;
- b) brenda 3 vjetësh nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare për TVSH;
- c) brenda 5 vjetësh nga afati i përfundimit të një kontrolli në vend për tatimin mbi fitimin;
- d) brenda tre vjetësh nga data e dërgimit të listpagesës fillestare;
- e) brenda tre muajsh nga data e nxjerrjes së një vendimi për bllokimin e llogarive për efekt të mospagimit të një detyrimi tatimor të tatimit mbi fitimin;
- f) brenda tre 36 muajsh nga datat e deklaratës fillestare të TVSH, për një ndryshim në shumën e TVSH së zbritshme;
- g) brenda 5 vjetësh nga nxjerrja e një vendimi apelimi në favor të tatimpaguesit;
- h) a + c.

Përgjigja e saktë është alternativa B

##### 2. Cilat përfshihen në tatimet dhe taksat kombëtare:

- a) tatimi mbi vlerën e shtuar;
- b) tatimi mbi të ardhurat;
- c) akciza;
- d) tatimi për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet;
- e) taksat kombëtare;
- f) Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- g) a+b+c+d+e;
- h) Të gjitha më sipër.

Përgjigja e saktë është alternativa G

### **3. Tatimpaguesi mund të ankimoje kunder:**

- a) Çdo njoftim vlerësimi;
- b) Çdo vendimi që ndikon në detyrimin tatimor të tij;
- c) Çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor;
- d) Çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor;
- e) Cdo detyrimin të dale nga nje deklarate e vetedeklaruar prej tij;
- f) a+b+c+d;
- g) a+b+c;
- h) Asnje nga sa më sipër.

Përgjigja e saktë është alternativa F

### **4. E drejta e tatimpaguesit per te kerkuar rimbursimin te teprices kreditore:**

- a) Parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës;
- b) Parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore fillestare, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës;
- c) Parashkruhet kur kanë kaluar 5 vjet nga data e dorëzimit të deklaratës tatimore, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës;
- d) Parashkruhet, brenda 3 vitesh kur nuk ka kaluar procedure kontrolli;
- e) Parashkruhet brenda 3 vitesh nga data e dorezimit te deklarates tatimore fillestare
- f) Nuk parashkruhet asjehere, nese ka kaluar procedure kontrolli;
- g) Nuk parashkruhet asnjehere;
- h) Asnje nga sa me siper.

Përgjigja e saktë është alternativa A

### **5. Sipas parashikimeve në ligjet e veçanta tatimore, tatimpaguesi, statusi i te cilit ndryshon nga një kategori në tjetrën:**

- a) duhet te njoftojë administratën tatimore brenda 10 diteve kalendarike nga data e regjistrimit te ndryshimit;
- b) duhet te njoftojë administratën tatimore brenda 15 diteve kalendarike nga data e regjistrimit te ndryshimit;
- c) duhet te njoftojë administratën tatimore përkatëse brenda 20 diteve kalendarike nga data e regjistrimit te ndryshimit;
- d) duhet te njoftojë administratën tatimore përkatëse brenda 30 diteve kalendarike nga data e regjistrimit te ndryshimit;
- e) nuk ka detyrim për të njoftuar ndryshimet pranë adminsitratës tatimore;
- f) duhet te njoftojë administraten tatimore përkatëse, në momentin e parë që i jepet mundësia;
- g) asnjë nga sa më sipër;

h) njofton vetëm administratën vendore.

**Përgjigja e saktë është alternativa B**

**6. Përcaktoni përgjigjen e saktë lidhur me afatet për administrimin e vlerësimit tatimor për rastet e mëposhtme:**

- a) administrata tatimore, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor;
- b) administrata tatimore, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor;
- c) administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor;
- d) njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e tij regjistrohen në dosjen e tatimpaguesit, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e lëshimit ;
- e) a + d ;
- f) tatimpaguesi mund të ankimojë njoftimin e vlerësimit në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni ;
- g) tatimpaguesi mund të ankimojë njoftimin e vlerësimit në drejtorinë e apelimit tatimor, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e nxjerrjes së tij;

**Përgjigja e saktë është alternativa C**

**7. Strukturat e verifikimit dhe koordinimit në terren kanë si funksion parësor:**

- a) marrjen e masave administrative për kundërvajtjet administrative tatimore;
- b) zbatimin e masave shtrënguese;
- c) kontrollin e thelluar të cdo tatimpaguesi;
- d) këshillimin e tatimpaguesve;
- e) a+b+c;
- f) a+b+d;
- g) a+b;
- h) Të gjitha më sipër.

**Përgjigja e saktë është alternativa G**

**8. Tatimpaguesi mund të nënshkruajë një marrëveshje të pagesës me këste kur:**

- a) ka paguar paraprakisht 10 % të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja;
- b) objekt i marrëveshjes është një detyrim i sigurimeve shoqërore;
- c) objekt i marrëveshjes është një gjobë në kontributet e sigurimeve shoqërore;
- d) objekt i marrëveshjes është një detyrim i kontributeve të sigurimeve shëndetësore;
- e) a + b + c + d;

- f) periudha e kërkuar për t'u shtrirë në kohë marrëveshja është brenda 36 muajve nga data e krijimit të detyrimit tatimor të papaguar;
- g) objekt i marrëveshjes është një detyrim i tatimit mbi fitimin, i nxjerrë pas një vlerësimi tatimor të administratës tatimore ose nga vet-deklarimi;
- h) objekt i marrëveshjes është një detyrim i tatimit mbi të ardhurat i mbajtur në burim.

Përgjigja e saktë është alternativa G

**9. Përcaktoni alternativën e saktë lidhur me hapat e mëposhtëm që lidhen me vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor:**

- a) detyrimi tatimor i papaguar sigurohet për aq sa është shuma totale e këtij detyrimi;
- b) tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë masën e sigurimit, direkt në Gjykatën Administrative;
- c) tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë masën e sigurimit, direkt në Drejtorinë e Apelit tatimor;
- d) tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë masën e sigurimit, tek drejtuesi i Drejtorisë Tatimore ku është regjistruar;
- e) tatimpaguesi ka të drejtë të ankimojë masën e sigurimit, tek drejtuesi i Drejtorisë së mbledhjes së detyrimeve të papaguara;
- f) masa e sigurimit të detyrimit të papaguar vendoset vetëm për pasurinë e paluajtshme;
- g) masa e sigurimit të detyrimit tatimor vendoset vetëm për pasurinë e luajtshme;
- h) administrata tatimore paraprakisht, nuk e informon tatimpaguesin përpara vendosjes ndaj tij të masës së sigurisë.

Përgjigja e saktë është alternativa E

**10. Autoritetin për të iniciuar një kontroll tatimor të kryer nga administrata Tatimore Qendrore, e ka:**

- a) Drejtoria Rajonale Tatimore, ku subjekti është i regjistruar;
- b) Drejtoria e Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- c) Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
- d) Drejtoria Rajonale Tatimore ose njësitë e tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me funksione të njëjta me të;
- e) a+b;
- f) a+b+c;
- g) b+c;
- h) anjë nga sa më sipër.

Përgjigja e saktë është alternativa D

### **11. Nuk konsiderohen si seli të përhershme:**

- a) një zyrë administrative,
- b) një degë,
- c) një fabrikë,
- d) një punishte
- e) një minierë apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore
- f) një shesh ndërtimi, rikonstruksioni, instalimi apo montimi
- g) mjediset e përdorura vetëm për qëllim magazinimi apo ekspozimi të mallrave
- h) të gjitha më sipër

Përgjigja e saktë është alternativa G

### **12. Nga te ardhurat e mëposhtme që siguron në një vit një individ rezident shqiptar, përcakto llojet e të ardhurave personale për të cilat nuk paguan tatim.**

- a) Te ardhurat personale nga punësimi part-time në Albanian University;
- b) Te ardhura nga pensioni që merr pasi ka punuar si pedagog në Universitetin e Tiranës;
- c) Te ardhurat në formë interesi nga depozita e kursimit që ka në Bankën Raiffeissen;
- d) Te ardhurat që mori në formë demshperblimi nga kompania e sigurimit "Insig" për shkak të rënies së zjarrit në shtëpinë e tij;
- e) Te ardhurat që mori nga shteti për shkak të shpronësimit të një sipërfaqe toke që dispononte, pasi do të ndërtohej një autostradë;
- f) Te ardhurat nga pensioni i marrë në Itali;
- g) b + d + e;
- h) b + d + e + f.

Përgjigja e saktë është alternativa H

### **13. Në cilin nga rastet personi i tatueshëm, ka të drejtën e zbritjes së TVSH së paguar në blerje.**

- a) Kryen furnizime eksport mallrash;
- b) Kryen furnizimin shërbimi postar nga shërbimi publik postar;
- c) Kryen furnizime shërbimesh të akomodimit në strukturat akomoduese;
- d) Kryen furnizime të shërbimeve veterinare, për kafshët shtëpiake;
- e) Kryen furnizimin e shërbimeve të reklamave nga media e shkruar;
- f) A+b+c+d+e;
- g) A+b+c;
- h) A+c+d.

Përgjigja e saktë është alternativa H

#### 14. Përfaqësuesi Tatimor:

Në cilin rast nuk duhet të emërojë një përfaqësues tatimor në Shqipëri, një shoqëri jorezidente e cila furnizon shërbime të telekomunikacionit, duke rrethuar alternativën përkatëse.

- a) Blerësi është një student në fakultetin e ekonomisë;
- b) Blerësi është një person i tatueshëm;
- c) Blerësi është një Bashki ;
- d) Blerësi është një shkollë e mesme e profilit të Teknologjisë dhe Informacionit;
- e) Blerësi është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ;
- f) a + b ;
- g) Asnjëra ;
- h) Në të gjitha rastet.

Përgjigja e saktë është alternativa B

#### 15. Cila nga alternativat janë furnizime shërbimi:

- a) Kalimi i një pasurie të patrupëzuar, pavarësisht nëse përfaqësohet ose jo me titull pronësie;
- b) Operacionet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes;
- c) Transaksionet mbi aksionet, pjesëmarrjet në shoqëri, obligacionet dhe titujt e tjerë;
- d) Qiraja financiare leasing;
- e) Transferimi i veprimtarisë ekonomike;
- f) Furnizimet të bëra prej një të punësuarit për punëdhënësin;
- g) a+b+c+d;
- h) c+d+e+f.

Përgjigja e saktë janë alternativat a), b) dhe c)

#### 16. Gjeni alternativën e gabuar: Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të liberalizuara;
- d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- h) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Përgjigja e saktë është alternativa C

**17. Për qëllime të ligjit për akcizat, konsiderohen hedhje për konsum në territor të gjitha më poshtë përveç:**

- a) dalja, përfshirë edhe daljen e parregullt, e produkteve të akcizës nga një regjim i pezullimit të detyrimeve;
- b) mbajtja e produkteve të akcizës jashtë një regjimi pezullues të detyrimeve, ku akciza nuk është vjelë sipas këtij legjislacioni;
- c) prodhimi, përfshirë edhe prodhimin e parregullt, i produkteve të akcizës, jashtë një regjimi të pezullimit të detyrimeve;
- d) importi, përfshirë edhe importin e parregullt, i produkteve të akcizës, përfshirë dhe rastin kur produktet, menjëherë pas importit, janë futur nën një regjim të pezullimit të detyrimeve;
- e) momenti i dërgimit të produkteve të akcizës nga një depozitues i miratuar drejt një personi juridik ose fizik, që nuk është i autorizuar të presë mallra akcize nën regjimin e pezullimit të detyrimeve;
- f) momenti i konsumimit të produkteve të akcizës për qëllime vetjake brenda ambienteve të magazinës fiskale;
- g) momenti i krijimit të humbjeve apo firove të produkteve të akcizës, me përjashtim të humbjeve dhe firove të shfaqura gjatë periudhës së pezullimit të detyrimeve;
- h) dita kur autorizimi i depozituesit të miratuar ose autorizimi i përjashtimit nga detyrimi i akcizës pushojnë së qeni të vlefshëm, sipas dispozitave të këtij ligji.

Përgjigja e saktë është alternativa D

## **PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

1. Cilat janë rastet që administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit?

### **Përgjigje:**

Rastet kur administrata tatimore përdor metodat alternative të vlerësimit tatimor janë, kur :

- Tatimpaguesi nuk dorëzon deklaratën tatimore, në afat.
  - Deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara.
  - Tatimpaguesi nuk mban llogari apo regjistrime të sakta .
  - Tatimpaguesi nuk bashkëpunon me kontrollin tatimor të autorizuar.
  - Tatimpaguesi nuk vë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumentat për llogaritjen e tatimit.
  - Transaksione me persona të lidhur, jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose pa efekte ekonomike thelbësore.
  - Transaksione shitblerjeje me para në dorë, që tejkalojnë shumën limit të Cash.
  - Nuk përdor rregullisht pajisjen e faturimit.
  - Tatimpaguesi ka Status “person fizik ”, por mban më tepër se një NIPT.
  - Tatimpaguesi ndërmer veprime që deformojnë parimet e ligjit tatimor.
  - Marrëveshje midis palëve të cilat kanë si qëllim kryesor apo një ndër qëllimet kryesore sigurimin e përfitimeve tatimore.
2. Pershkruani hapat dhe afatet qe duhet të ndjekë tatimpaguesi gjatë ankimimit administrative. Çfarë ndodh me Vendimin e Struktues se Apelimit Tatimor?

### **Përgjigje:**

- Tatimpaguesi brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i marrjes së njoftimit apo momentit kur vlerësohet se njoftimi është marrë, duhet t'i drejtoje kerkese me shkrim struktues se Apelimit Tatimor, prane Ministrise se Financave.
- Në qoftë se ankimi dorëzohet pranë një organi jokompetent (për shembull në Drejtorinë Rajonale Tatimore ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve), afati i ankimit vlerësohet i respektuar nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent.
- Tatimpaguesi, që kërkon të ankimojë, duhet që bashkë me kërkesën për ankimim, te paguaje shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë minimalisht 6 muaj, por jo më pak se afati, sipas të cilit vendimi ka marrë formë të prerë për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore, pervec gjobave dhe kamatëvonesave të llogaritura nga vlerësimi tatimor.
- Pagesa e plotë, apo vendosja e garancisë bankare, për vlerën e plotë të detyrimit tatimor (pa gjobat dhe kamatëvonesat) është kusht për marrjen në shqyrtim të ankimit nga Struktura e Apelimit tatimor.
  - Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kërkesave të përmendura me lart, Drejtoria e Apelimit Tatimor ose komisionit i kërkon tatimpaguesit ta ridërgojë ankimin e tij të plotësuar si duhet me



informacionin e kërkuar brenda 15 ditëve kalendarike. (me përjashtim të pagesës). Periudha e shqyrtimit të apelimit prej 60 ditësh fillon vetëm në qoftë se plotësohen si duhet të gjitha kërkesat. Periudha pra zgjatet deri në më pak se një muaj kur ankimi nuk është plotësuar si duhet.

- Vendimi i Struktues se Apelimit Tatimor është i detyrueshëm për zbatim nga organi i administratës tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor dhe nuk apelohej prej tij.
- Ky vendim i dergohet me poste rekomande Tatimpaguesit dhe organit të Administratës tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor ose ka marrë vendimin, që është objekt i ankimit dhe është pjesë e dosjes së tatimpaguesit.
- Brenda 30 diteve nga data e marrjes dijeni për Vendimin, tatimpaguesi mund ta kundërshtojë atë në gjykatë. Gjithashtu, tatimpaguesi mund të ankohej drejtpërdrejt në gjykatë, nëse struktura e Apelimit tatimor nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit të plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar në ligj.
- Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.

3. Shpjegoni se cilat janë shpenzimet e zbritshme për individët që plotësojnë deklaratën vjetore individuale të të ardhurave.

### **Përgjigje:**

Shpenzimet e zbritshme për individët që plotësojnë deklaratën vjetore individuale të të ardhurave janë:

- a) shumat e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;
- b) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.

4. E drejta e zbritjes lind kur TVSH-ja e zbritshme bëhet e kërkueshme sipas ligjit Nr 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Cilat janë kushtet, të cilat i japin personit të tatueshëm të drejtën e zbritjes së TVSH?

### **Përgjigje:**

1. **Kushti formal** - Të disponojë faturën e fiskalizuar për blerje brenda vendit, ose deklarata doganore e importit.
  2. **Kushti kohor** - E drejta e zbritjes lind kur TVSH-ja e zbritshme bëhet e kërkueshme. Por kjo e drejtë nuk mund të shtrihet në kohë përtej 12 periudhave tatimore.
  3. **Kushti thelbësor** - Të gjitha blerjet duhet t'i shërbejnë furnizimeve të tatueshme dhe veprimtarisë ekonomike të pavarur.
5. Diskutoni si përcaktohet baza e taksës mbi truallin, si llogaritet detyrimi i taksës mbi truallin dhe në buxhetin e cilës bashki paguhet kjo taksë.

### **Përgjigje:**

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Taksa e mbledhur, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

6. Diskutoni çfarë janë pullat fiskale dhe kur është momenti që pullat e akcizës vendosen në produktet e akcizës.

### **Përgjigje:**

Pulla fiskale është dokument me vlerë dhe është monopol shtetëror.

Pullat e akcizës vendosen në produktet e akcizës në momentin e hedhjes për konsum.

Kodet e sigurisë printohen dhe pullat e akcizës do të aplikohen direkt mbi produktet përkatëse, gjatë prodhimit në linjat plotësisht të automatizuara të mbushjes nga prodhuesit në shkallë të madhe apo nga ata importues të birrës apo pijeve të tjera alkoolike, që janë autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Prodhuesit apo importuesit e tjerë do të aplikojnë pullat e akcizës sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave

7. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune, dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës. Diskutoni rastet se çfarë nuk përfshihen në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore.

### **Përgjigje:**

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor, nuk përfshihen:

- a) përfitimet që punëmarrësi merr nga fondet e sigurimeve shoqërore;
- b) kompensimet nga rritja e çmimeve;
- c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;
- ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykatë;
- d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në

fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara;

e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit, të cilat jepen bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që nuk janë pjesë e pagës;

ë) honorarët apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

## USHTRIME

### Ushtrimi 1 (6 pikë)

Tatimpaguesi “A”, e regjistruar për TVSH dhe Tatim mbi Fitimin, në datën 3 maj 2023, punësoi 7 punonjese të reja, të cilat filluan punë menjëherë. Për shkak të panjohura, nga Sektori i Burimeve Njerezore, nuk u krye njoftimi pranë Administratës Tatimore, sipas Ligjit, për këto punësime.

Në datën 8 Maj, nga strukturat e verifikimit në terren të Administratës Tatimore, u konstatua që këto 7 punonjese ishin në marrëdhënie punë pranë kësaj shoqërie.

1. Cili ishte detyrimi i shoqërisë “A” për deklarin e 7 punonjeseve?
2. Cili është penaltetit që do të marrë shoqëria “A”?

### Përgjigje:

a. Shoqëria “A” duhet të deklaronë punësimin rishtaz të punonjeseve, në llogarinë e saj të deklarin elektronik e-filing, të pakten 1 ditë përpara fillimit të punës.

b. Duke qenë se shoqëria “A”, e regjistruar për TVSH dhe Tatim mbi Fitimin, nuk e ka zbatuar detyrimin sipas pikës a., atëherë ajo denohet me gjobe për çdo punonjës të padeklarin prej 200.000 (dyqind mijë) lekesh, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit

Gjoba në total  $7 \times 200.000 = 1.400.000$  leke

### Ushtrimi 2 (6 pikë)

Tatimpaguesi “A”, subjekt tregtar dëshiron të ndërprejë aktivitetin për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data 15 qershor 2023. Aktualisht ai ka detyrime tatimore të papaguara, të cilat i shfaqen në llogarinë e tij në e-filing dhe për të cilat janë gjeneruar urdherpagesat përkatëse.

- a. Përkruani hapat që duhet të ndjehet Tatimpaguesi dhe detyrimet që ai ka për deklarin pas datës së miratimit të pezullimit të aktivitetit.
- b. Nëse tatimpaguesi ka lidhur dhe ka aktive një marrëveshje të pagesës me keste me Drejtorinë

- Rajonale Tatimore, a mund te aplikoje per pezullim aktiviteti?
- c. Si mund te rifilloje ushtrimin e aktivitetit?

**Përgjigje:**

- a) Tatimpaguesi duhet te paguaje te gjitha detyrimet e papaguara qe i shfaqen ne sistem. Me pas te aplikoje ne QKB per pezullim te aktivitetit me afat te pacaktuar.

Pavaresisht miratimit te pezullimit te aktivitetit, duhet te deklaroje deklaratat tatimore dhe paguaje detyrimet per periudhat perfshire Qershor 2023 dhe deklaraten vjetore 2023, brenda afateve ligjore.

Per periudhat Korrik 2023 e ne vijim, per sa kohe eshte pasiv, nuk i gjenerohen deklarata tattimore dhe nuk ka detyrim per te deklaruar dhe paguar.

- b) Tatimpaguesi nuk mund te pezulloje aktivitetin, nese ka lidhur dhe ka aktive nje akt-marreshje per pagese me keste te detyrimeve
- c) Tatimpaguesi duhet te beje kerkese per riaktivizim ne QKB perpara rifillimit te aktivitetit.

**Ushtrimi 3 (6 pikë)**

Individi “Y” rezident për qëllime tatimore në Itali (Italia është vendi me të cilin interesat e tij jetësore dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë), por ka interesa jetësore dhe ekonomike të lidhura edhe me Shqipërinë.

Në muajin Maj 2021 ai shiti një apartament banimi në pronësi të tij (pasuri e vendosur në Shqipëri). Fitimi kapital i realizuar ishte 3.500.000 lekë për të cilin pagoi tatim lidhur me kalimin e të drejtës së pronësisë 525,000 leke

Në muajin Gusht 2021, ai së bashku me familjen e tij u zhvendos në Tiranë, ku hapi një aktivitet ekonomik si Person Fizik, për të cilin kreu regjistrimin në QKB në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Të ardhurat që realizoi si person fizik i regjistruar për periudhën Gusht – Dhjetor 2021 ishin 3,500,000 lekë.

**Kërkohet:**

- a) A kishte detyrim ligjor Individi “Y” për të dorëzuar në administratën tatimore shqiptare deklaratën individuale vjetore të të ardhurave të realizuara për vitin 2021?
- b) Nëse po, për vitin 2021, ai duhet të plotësojë deklaratën si Rezident apo si Jorezident në Shqipëri?
- c) Sa ishin të ardhurat bruto të tatueshme që pasqyrohen në deklaratën e tij individuale të të ardhurave dha sa ishte tatimi për t’u paguar?

**Përgjigje:**

- a) Individi Y ka detyrim per te dorezuar deklaratën individuale vjetore të të ardhurave të realizuara për vitin 2021 në administratën tatimore shqiptare pasi ka realizuar te ardhura nga shitja e apartamentit ne vleren 3.500.000. Pra ka realizuar te ardhura ne vleren mbi 2,000,000 leke.

Individi Y ka detyrim për të dorëzuar deklaratën individuale vjetore të të ardhurave vetëm për fitimin kapital të realizuar në vlerën 3.500.000 lekë.

b) Individi Y duhet të plotësojë deklaratën si jorzident në Shqipëri pasi nuk plotëson kushtin e koheqendrimit në Shqipëri, pra kushtin që individi duhet të qëndrojë më shumë se 183 ditë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë tatimore 365 ditë.

Sipas rastit individi është zhvendosur në Shqipëri në muajin Gusht 2021 pra për vitin 2021 nga muaji gusht deri në dhjetor ai ka më pak se 183 ditë koheqendrim.

c) Të ardhurat bruto të tatueshme = 3,500,000 leke, Tatimi (15%) = 525,000 leke

Për të ardhurat e realizuara si person fizik në vlerën 3,500,000 lekë nuk do të përfshihen në të ardhurat bruto vjetore që pasqyrohen në deklaratën e tij individuale të të ardhurave pasi këto të ardhura do të pasqyrohen në deklaratën e tatimit të thjeshtuar të fitimit që dorëzohet jo më vonë se data 10 shkurt e vitit pasardhës. Personi fizik tregtar nuk ka përgjegjësi të ndryshme nga individi, si në rastin e shoqërive, kështu që ata nuk kanë të detyrim të paguajnë tatim mbi të ardhurat personale për fitimin pas tatimit apo tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

#### **Ushtrimi 4 (6 pikë)**

Shoqëria “Rilind 2015” Shpk ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri e regjistruar në QKB ku ka selinë e përhershme. Ka filiale të saj në Itali dhe në Kosovë. Për vitin 2021 ka këto tregues në lidhje me fitimin, sipas bilancit të konsoliduar:

- Fitimi në Shqipëri për shumën 80.000.000 leke;
- Fitimi në Itali për shumën e konvertuar në leke për shumën 20.000.000 leke;
- Fitimi në Kosovë për shumën 40.000.000 leke.

Normat tatimore për TF (tatimin mbi fitimin) është në Kosovë 5% ndërsa në Itali 25%. Shqipëria ka marrëveshje të eliminimit të taksimit të dyfishtë me të dy shtetet, Kosovë dhe Itali.

1. Llogarisni tatimin e paguar në çdo vend.
2. Llogarisni sa do të jetë tatimi për t'u paguar në Shqipëri, duke zbatuar rregullat e përcaktuara në marrëveshjet për eliminimin e taksimit të dyfishtë.

#### **Përgjigje:**

Fitimi për deklaram në Shqipëri dhe i tatueshem, është në total:  $80+40+20=140$  milion lekë

Tatimi i llogaritur në Shqipëri :  $140.000.000 \times 15\% = 21.000.000$  lekë.

Fitimi i Italisë i njohur është  $20 \text{ mil} \times 25\% = 5$  milion

Fitimi i Italisë me norme shqiptare:  $20 \text{ mil} \times 15\% = 3$  milion (paguar në Itali: 5 milionë)

Fitimi kosoves me norme shqiptare:  $40 \times 15\% = 6$  mil.

Fitimi i kosoves i njohur:  $40 \text{ mil} \times 5\% = 2$  mil (paguar në Kosovë: 2 milionë)

Gjithsej TF për t'u njohur nga pagesat e filjaleve jashtë vendit është:  $3+2=5$  milion

TF përfundimtar për t'u paguar është:  $21-5=16$  milion

Sipas te dhenave te ushtrimit filiali eshte “seli e perhershme” si ne Itali dhe ne Kosove, keto shoqeri zbatojne dispozitat e legjislacionit tatimor vendas/vendeve respektive.

Shoqeria Rezidente ne Shqiperi “Rilind 2015” ben bilanc te konsoliduar dhe paguan tatim fitimi ne zbatim te nenit 17 “Detyrimi per t’u paguar” te ligjit nr.8438, date 28.12.1998 “ Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, per totalin e fitimeve te realizuara brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Sipas nenit 37 të Ligjit nr.8438, date 28.12.1998 “ Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, i lejoht kreditimi i tatimit të huaj, por deri në nivelin e tatimit Shqiptar për ato të ardhura (fitimi i realizuar nga filiali/filialet) (pra deri në 15%). Pra për të ardhurat e realizuara në Itali, duke qenë se niveli i tatimit është më i lartë në Itali, për ato të ardhura kreditohet tatim ne Shqiperi 15% dhe nuk paguhet tatim në Shqipëri. Për të ardhurat e realizuara në Kosovë, duke qenë se në Kosovë janë paguar 5% atëhere kjo shumë kreditohet nga tatimi shqiptar për ato të ardhura.

## **Ushtrimi 5 (7 pikë)**

Shoqeria “**Market Europe**” **sh.p.k** e cila merret me tregtimin e artikujve te konsumit te gjere me shumice dhe pakice, ka kryer keto veprime tregtare gjate vitit 2020.

### **I. Ne lidhje me shitjet jane keto te dhena:**

- a- Ka realizuar shitje mallrash me vlere pa TVSH 180.000.000 leke me fature tatimore per shoqeri te tjera tregtare, te cilat jane likuiduar nga keto shoqeri.
- b- Ka shitur mallra me pakice me kupon tatimor per konsumatorët finale ne rrjetin e supermarketëve qe disponon, duke realizuar qarkullim me gjithë TVSH prej 60.000.000 leke.
- c- Ka eksportuar ne Kosove mallra me vlere 70.000.000 leke dhe pagesat jane kryer ne banke.
- d- Ka kryer furnizime mallrash ne lidhje me nje kontrate me nje institucion per shumen 100.000.000 leke pa tvsh, likuiduar pjesisht nga thesari ne vitin 2020.

### **II. Ne lidhje me blerjet e mallrave jane keto te dhena:**

- e- Ka blere mallra gjate vitit nga furnitore vendas per 190.000.000 milion leke (vlere pa tvsh). Nga te dhenat e inventarit, rezulton se gjendja e mallrave ne magazine dhe ne dyqane ne fund te vitit 2020 eshte 30.000.000 leke, gjendja ne fillim, ne date 01 Janar 2020 ka qene 0 leke.
- f- Ka kryer importe mallra per vleren e importit sipas faturave te huaja ne 500.000 euro, ka paguar takse doganore (TD) ne favor te doganes per vitin 2020 ne total per shumen 10.000.000 leke. (Kursi i konvertimit eshte marre 1 euro = 120 leke ).

### **III. Ne lidhje me shpenzimet e kryera:**

- g- Ka kryer shpenzime te shitjes (transport, magazinim, manipulim, etj). ne shumen 25.000.000 leke, sipas kontabilizimit te tyre ne llogarite e shpenzimeve
- h- Shpenzimet e pergjithshme administrative jane 10.000.000 leke
- i- Ka paguar nje gjobe te vendosur nga administrata tatimore per 1.000.000 leke, per nje

shkelje te konstatuar.

- j- Nje pjese te mallrave ne natyre me vlere 5.000.000 leke shoqeria i ka perdorur per perdorim personal ne favor te punonjesve te saj.
- k- Ka kryer shpenzime dhe ka paguar 3.000.000 leke per rikonstruksionin e rrjetit elektrik te magazinave, por nuk ka marre fature tatimore nga furnizuesi i ketij sherbimi dhe nuk ka dokumentacion justifikues.
- l- Shpenzimet e tatimpaguesit per pagat dhe sigurimet e detyrueshme shoqerore dhe shendetsore jane 12.000.000 milion leke.
- m- Shpenzime furnitura, uje, energji,etj per shumen 15.800.000 leke.
- n- Ka kryer shpenzime per pritje percjellje, shpenzime perfaqesimi te kontabilizuara ne total per 3.000.000 leke. (Kufiri i lejuar 0,3 % e qarkullimit vjetor).

#### **IV. Ne lidhje me aktivet e shoqerise jane keto te dhena:**

- o- Vlera kontabel e mbetur e ndertesave te shoqerise eshte 40.000.000 leke. Norma vjetore e amortizimit te tyre 5 %
- p- Vlera e mbetur kontabel e grupit makineri dhe pajisje te shoqerise eshte 20.000.000 leke. Norma vjetore e amortizimit te tyre 20 %

#### **V. Pervec sa me siper, ne fund te vitit rezultojne dhe keto te dhena:**

- *Ka paguar gjate vitit shumen prej 10.000.000 leke tatim mbi fitimin (TF) paradhenie paguar gjate vitit 2020 sipas kesteve te percaktuara.*

#### **Kerkesa:**

- 1- Llogarisni te Ardhurat e tatimpaguesit per vitin 2020.
- 2- Logarisni: shpenzimet e shoqerise per vitin 2020 duke i ndare ne shpenzime te njohura dhe shpenzime te panjohura.
- 3- Logarisni rezultatin e shoqerise duke specifikuar fitimin e shoqerise, fitimin per efekt te rezultatit fiskal. Beni komentet perkatese.
- 4- Llogarisni tatimin mbi fitimin sipas te dhenave te shoqerise dhe shumen qe paguan shoqeria me dorezimin e pasqyrave financiare prane tatimeve ne daten 31 Mars 2021.

#### **Përgjigje:**

#### **Te ardhurat :**

Te ardhurat nga shitjet me fature tatimore per shoqeri te tjera 180.000.000 leke

Te ardhurat nga shitjet me pakice 50.000.000 leke (tvsh 10mil)

Te ardhurat nga eksportet 70.000.000 leke.

Te ardhurat per kontraten 100.000.000 leke

**Te ardhurat gjithsej 400.000.000 leke**

## Shpenzimet:

1. Shpenzime blerje mallra brenda vendit (KMSH): 160.000.000 milion leke (blerjet 190 mil+gjendja ne fillim 0 leke – gjendja ne fund 30 milion)
2. Shpenzime import mallarsh (500.000eur x120)= 60.000.000 + 10.000.000 (TD) = 70.000.000 leke
- 3- Shpenzime te shitjes 25.000.000 leke.
- 4- Shpenzimet e pergjithshme administrative 10.000.000 leke
- 5- Shpenzimet per pagat dhe sigurimet 12.000.000 milion leke.
- 6- **Shpenzime amortizimi ndertesa 2.000.000 leke**
- 7- **Shpenzime amortizimi makineri e pajisje 4.000.000**
- 8- Shpenzime furnitura, sherbime te tjera 15.800.000 leke
- 9- Niveli i njohur i shpenzimeve te perfaqesimit 1.200.000 (400 milion x 0,3 % = 1.200.000 leke. Pra nga 3.000.000 leke shpenzime perfaqesimi dhe shpenzime per pritje percjellje, vetem 1.200.000 leke jane te zbritshme dhe 1.800.000 leke te panjohura.

## **Totali i shpenzimeve te njohura 300.000.000 leke**

Shpenzimet e meposhtme jane shpenzime te panjohura per efekte te llogaritjes se tatim fitimit:

- 1- *Pagesen e nje gjobe te vendosur nga administrata tatimore per 1.000.000 leke*
- 2- *Mallrave me vlere 5.000.000 leke qe shoqeria i ka perdorur per perdorim personal ne favor te punonjesve te saj.*
- 3- *Pagesen per 3.000.000 leke per rikonstrukcionin e rrjetit elektrik te magazinave per e cilin nuk ka dokumenta*
- 4- *Diferencen prej 1.800.000 leke te shpenzimeve te perfaqesimit*

**Jane shpenzime te panjohura ne total 10.800.000 leke.**

**Shpenzimet gjithsej :** 300.000.000 +10.800.000=310.800.000 leke.

**-Rezultati kontabel :** 400.000.000-310.800.000=89.200.000 leke.

**-Rezultati fiskal:** 400.000.000– 310.800.000 +10.800.000 = 100.000.000 leke,

**Tatimi mbi fitimin 100.000.000 x 15 % = 15,000,000 leke**

Diferenca e tatimit mbi fitimin per tu paguar 15.000.000 – 10.000.000 = **5.000.000 leke paguhet me dorezimin e deklarates** (kjo pasi tatimi i paguar paradhënie sipas kësteve zbritet nga shuma totale e tatimit të llogaritur).

## **Ushtrimi 6 (6 pikë)**

Një person i tatueshëm i identifikuar për TVSH-në në Austri i kryen një shërbim trajnimi një banke në Shqipëri. Tema e trajnimit do të jetë lidhur me mënyrën e sjelljes së punonjësve të bankës me klientët e saj.

Person i tatueshëm i identifikuar për TVSH-në në Austri lëshon faturë në vlerën 1000 euro = 140.000 lekë



Si do regjistrohet kjo faturë te librat dhe në deklaratën e TVSH-së dhe cfarë efektsh jep për TVSH-në te tatimpaguesi ne Shqiperi?

### **Përgjigje:**

“Banka mbasi merr faturën nga Personi i tatueshëm në Austri per 1000 euro = 140.000 lekë në momentin që kryhet shërbimi i trajnimit për punonjësit e bankës kryen procedurën e vetëfaturimit (faturë e lëshuar nga blerësi), duke aplikuar TVSH për këtë furnizim.

Këtë faturë, banka e deklaron te rubrika e deklaratës së TVSH-së së blerjeve të përjashtuara në vlerën 168.000 lekë, (140.000 lekë vlera e blerjes dhe TVSH në vlerën 28.000 lekë), pasi aktiviteti i bankës është i përjashtuar dhe nuk lejohet zbritja e TVSH-së.

Gjithashtu, vlera prej 140.000 lekë (vlerë e tatueshme) i llogarit TVSH-në  $140.000 \times 20\%$  dhe deklaron në rubrikën auto-ngarkesës së TVSH-së, (reverse-charge) në shitje, duke llogaritur TVSH në shitje në vlerën 28.000 lekë.

Duke qënë se, TVSH nuk lejohet të zbritet nga banka, TVSH-ja prej 28.000 lekë do të paguhet në Shqipëri, nëpërmjet auto-ngarkesës së TVSH-së, (reverse-charge) nga marrësi i shërbimit personi i tatueshëm në Shqipëri (banka)”.

### **Ushtrimi 7 (6 pikë)**

Një person i tatueshëm me aktivitet tregti dhe projekte, gjatë muajit Maj 2023 ka kryer këto transaksione:

#### **Shitje**

- ka kryer shërbime konsulence prej 960.000 lekë, përfshirë TVSH;
- ka kryer shitje projekti me vlerë të tatueshme prej 600.000 lekë;
- ka kryer shitje mallrash për në Kosovë në vlerë prej 2.000.000 lekë;
- ka kryer shitje autoveture e blerë nga importi, me vlerë të tatueshme 1.000.000 lekë.

#### **Blerje (nga subjekte te regjistruara per TVSH)**

- ka kryer blerje, një autoveturë me vlerë të tatueshme 900.000 lekë
- ka kryer blerje mobilje të zyrës me vlerë të tatueshme prej 400.000.

#### **Të tjera**

- dhuruar stafit si shpërblim në natyrë me vlerë të tatueshme 200.000 lekë.
- përdorur për nevoja të zyrave mallra nga stoku i vet, blerë me vlerë të tatueshme 300.000 lekë.

Përcaktoni TVSH në Shitje, TVSH në blerje, dhe TVSH për t’u paguar për muajin Maj 2023.

### **Përgjigje:**

## Liber Shitje

	Vlera tatueshme	TVSH	
- shërbime konsulence	800.000	160.000	
- shitje projekti	600.000	120.000	
- shitje mallrash në Kosovë	2.000.000	0	
- ka kryer shitje autoveture	1.000.000	0	
- shperblim natyrë stafit	200.000	40.000	
- përdorur mallra për zyrat	300.000	60.000	
<b>TVSH Shitje</b>		<b>380.000</b>	

## Liber Blerje

	Vlera tatueshme	TVSH	Blerje/import i perjashtuar
- blerë mobilje zyre	400.000	80.000	
- blerë autoveturë	0	0	1,080,000
- përdorur mallra për zyrat	300.000	60.000	
<b>TVSH Blerje</b>		<b>140.000</b>	

**TVSH për t'u paguar = 240.000**

## Ushtrimi 8 (6 pikë)

Transferohet një veprimtari ekonomike që plotëson kushtet për t'u transferuar. Pjesë e aseteve është edhe një pajisje (makineri prodhimi). Makineria është blerë nga personi i tatueshëm A (transferuesi) më janar 2013. Personi i tatueshëm A në prill 2015 transferon veprimtarinë ekonomike tek personi i tatueshëm B marrës i transferimit, i cili do të vazhdojë të kryejë veprimtarinë ekonomike si personi i tatueshëm A. Personi i tatueshëm B (marrësi i transferimit) në tetor 2016 mbyll veprimtarinë ekonomike.

- Personi i tatueshëm B duhet të kryejë rregullimin e TVSH-së së zbritshme?
- Cila do të jetë periudha e rregullimit e TVSH-së së zbritshme dhe për sa vite?

## Përgjigje:

Rregullimi i zbritjes së TVSH-së për mallrat kapitale të luajtshme shtrihet përgjatë një periudhe të plotë prej 5 vitesh, duke filluar nga data, në të cilën mallrat janë blerë apo prodhuar.

Afati 5-vjeçar i rregullimit të TVSH-së së zbritshme do të fillojë nga data e blerjes së aktivitetit tek personi i tatueshëm A më Janar 2013 dhe jo nga data e transferimit të veprimtarisë tek personi i tatueshëm B, prill 2015. Kështu janar 2013 deri më tetor 2016 për qëllime të këtij rregulli konsiderohen 4 vjet. Rregullimi i TVSH-së së zbritshme nga B për këtë pajisje do të bëhet për 1/5 e TVSH-së së zbritshme në momentin e blerjes së pajisjes (makineri prodhimi).

## Ushtrimi 9 (6 pikë)

Genci është i punësuar pranë subjektit Beta me pagë mujore prej ALL 250,000. Gjithashtu, ai është i punësuar edhe pranë subjektit Alpha me page ALL 70,000. Paga maksimale per efekt te llogaritjes 141,500 lek. Kerkohet:

- Llogarisni kontributet që paguan Genci në secilin subjekt
- Llogarisni kontributet që paguan secili subjekt për Gencin
- Tregoni sa eshte paga minimale dhe maksimale per efekt te llogaritjes se sigurimeve shoqerore ne 31 Dhjetor 2022.

### Përgjigje:

a) Kontributet qe paguan Genci ne secilin subjekt jane:

Ne subjektin Beta sigurime shoqerore  $141'500 * 9.5\% = 13'443$  lek

Ne subjektin Beta sigurime shendetesore  $250'000 * 1.7\% = 4'250$  lek

Ne subjektin Alpha sigurime shoqerore  $0 * 9.5\% = 0$  lek

Ne subjektin Alpha sigurime shendetesore  $70'000 * 1.7\% = 1'190$  lek

b) Kontributet qe paguan secili subjekt per Gencin jane:

Subjekti Beta paguan sigurime shoqerore  $141'500 * 15\% = 21'225$  lek

Subjekti Beta paguan sigurime shendetesore  $250'000 * 1.7\% = 4'250$  lek

Subjekti Alpha paguan sigurime shoqerore  $0 * 15\% = 0$  lek

Subjekti Alpha paguan sigurime shoqerore  $70'000 * 1.7\% = 1'190$  lek

c) Ne 31 Dhjetor 2022 paga minimale per efekt te llogaritjes se sigurimeve shoqerore ka qene 34'000 leke dhe paga maksimale ka qene 149'954 leke.